



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

University "Ukshin Hoti" Prizren

ADMINISTRATA QËNDRORE

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: ëëë.uni-prizren.com

Prizren, më: 16.01.2023

| | |
|-------------------------------|--|
| Datë/a: | 16.01.2023 |
| Për/Za/To: | Komisionin Qëndror për Sigurimin e Cilësisë së Universitetit "Ukshin Hoti" |
| Nga/Od/From: | Nehat Gashi, koordinator i QKA-së |
| Tema/Subjekat/Subject: | Raport i aktiviteteve të QKA-së për vitet 2020-2022 |

Përmes këtij raporti paraqesim punën e kryer në QKA për periudhën kohore 01.01.2020 deri më 31.12.2022.

Universiteti "UKSHIN HOTI" nëpërmjet Qendrës së Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me S.T.A dhe MASHT, njofton te gjithë studentët që me datën 08.03.2020 në ora 11:00 zhvillohen testet nderkombetare te gjuhes angleze

Toefl ITP® dhe Toeic® L&R

Testet jane te miratura ne MASHT per te gjithë ata qe do te aplikojne per studimet Master dhe Doktorature.

Aplikimet behen vetem online ne: <https://sta-edu.com/registration/>

Testet jane ne formatin Paper Based (vetem me alternativa) dhe zgjasin vetem 2 ore. (08.03.2020)

Qendra e Karrierës&Alumni në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, në bashkëpunim me Këshilltarët e DIMAK Kosova dhe GIZ-in gjerman, të martën organizuan "Trajnim përgatitor për aplikime për studime postdiplomike dhe punësim". Në trajnim online, mjaft interaktiv, morën pjesë 100 pjesmarrës, të cilët e vlerësuan shumë të dobishëm për zhvillimin e njohurive të tyre. Në trajnim u shpjeguan në detaje elemente të rëndësishme siç janë: CV, Letra Motivuese dhe Teknikat e Intervistimit. Pjesëmarrësit e trajnimit gjithashtu u informuan rreth procesit të aplikimit, kriterëve dhe aplikimit të vizës për Ausbildung.

Në organizimin e këtij trajnimi kontribut dhanë edhe Parlamenti Studentor dhe Prof.Ass. Dr. Serdan Kervan, mesimdhënëse ne Fakultetin e Edukimit në Universitet. Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren edhe më heret ka bashkëpunuar me organizatën gjermane GIZ, dhe se në të ardhmen ky bashkëpunim dhe të zgjerohet dhe thellohet. (02.06.2023)

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02SQKyQ3s2qR1gKD8yrSxBenmlKGHnRhK8FXyH3ecJ92Z5XKcqsAv96PJAnVjWmsPfl&id=101240494940518

Qendra e Karrierës dhe Alumnit në bashkëpunim me Kosovo American Education Found – KAEF zhvilluan thirrjen e hapur për student që të marrin pjesë në infosesion për të u njoftuar rreth mundësive për Fellowship për trajnime dhe studime në universitetet Amerikane. (08.06.2020)

Qendra e Karrierës e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, të martën ka pranuar një mbështetje shumë të vlefshëm nga GTZ - Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar, ku përfshihen pajisje për kompletimin e zyrës.

Mbështetjen e pranuan pas një takimi që kishin udhëheqësi i Qendrës së Karrierës në UPZ, z. Nehat Gashi, dhe Prof. Ass. Dr. Serdan Kervan, mësimdhënës e e rregullt në UPZ, me përfaqësuesit e GTZ.

Z. Gashi me këtë rast në emër të universitetit i falënderoi përfaqësuesit e GTZ për këtë mbështetje të dobishëm, duke theksuar se kjo nuk është hera e parë e bashkëpunimit dhe e mbështetjes që gëzon universiteti unë nga kjo organizatë por edhe nga shteti Gjerman në përgjithësi.

Qendra e Karrierës&Alumni, është një urë lidhëse midis studentëve dhe punëmarrësve, po ashtu u shërben studentëve për ngritjen profesionale në forma të ndryshme, duke u ndihmuar në planifikimin e karrierës nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, takimeve të studenteve etj. (03.11.2020)

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0zsDiNEWSSzvFpHWvcp5ppJioPUVnoeYo7k4cxRtrLTJqboXag32LoMsbuyvTfvSGI&id=101240494940518

Universiteti “Ukshin Hoti” arrin marrëveshje bashkëpunimi me organizatën “Teach for Kosova” Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, përkatësisht Qendra për Zhvillim të Karrierës&Alumni ka nisur bashkëpunimin me organizatën “Teach for Kosova”, në fushën e promovimit, përkrahjes, fuqizimit dhe avancimit të studentëve dhe të diplomuarve. Për këtë qëllim të martën u nënshkrua edhe një Marrëveshje e Mirëkuptimit ndërmjet zv.Rektori Prof. Ass. Dr. Shemsi Morina, njëherësh Prorektor për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Kërkime Shkencore, dhe drejtorit ekzekutiv të TFK-së, z. Egzon Gashi, ku ishte prezent edhe udhëheqësi i Qendra për Zhvillim të Karrierës&Alumni në UPZ, z. Nehat Gashi, i cilës është angazhuar që kjo të realizohet.

Prorektori Morina, e ka vlerësuar si një nismë të mirë bashkëpunimin me organizatën TFK dhe për mbështetjen e ofruar prej tyre për Qendrën e Zhvillimit të Karrierës, e cila është duke bërë një punë shumë të mirë për studentët e universitetit tonë.

Ndërsa drejtori Gashi, bëri të ditur se bëhet fjalë për një projekt të rëndësishëm për përgatitjen e kuadrove të reja në fushën e arsimit. Sipas tij, TFK-ja do të trajnojë një grup të studentëve ekzistues apo alumni të përzgjedhur nga UPZ, në aftësi të buta, zhvillim të debateve, dhe aftësive të tjera të ngjashme së paku një herë në semestër.

Në kuadër të këtij Memorandumi, TFK-ja zotohet që brenda një periudhe 2-vjeçare të përgatisë dhe organizoj së paku një sesion informues në vit për studentët e UPZ, për t'i informuar mbi thirrjen për aplikim në programin e felloëship-it. Gjithashtu parashihet të organizohet së paku një fokus-grup me studentët për të mbledhur informata mbi vështirësitë e tyre në përcaktimet për karrierë, si dhe për qëllime të organizatës në definimin e profilit të mësimdhënësit-lider ideal. Në anën tjetër, përgjegjësi e UPZ është që të ofrojë përkrahje në organizimin e sesioneve informuese për Teach For Kosova me studentë, së paku një herë në vit duke i paraprirë hapjes së thirrjes për aplikim në programin e felloëship-it. (10.11.2020)

<https://www.facebook.com/UniversityofPrizren/posts/pfbid02W8nJgW7F2RH7J4vV5kuczQLz5Ma6uY7V26neB8cCpTnpgmrXqN5Z6DKWk6wthZxB1>

Shtëpia Botuese New Era Publications nëpërmjet QKA-së mbajnë seminarin online. Seminari trajton tematika, se si të përmirësojmë jetën tonë dhe të zgjidhim pengesat e padukshme në jetë, dhe si të përmirësojmë biznesin. Seminari u mbajtë me datë 20 Nëntor, në orën 20:00. Linku ku u regjistruan të gjithë të interesuarit.

<https://newerapub.com/webinar/beyond-business/>

Kodi qe do te vendosni është: library

Organizime të tilla janë shumë të pranuar nga student pasi që seminare të tilla po dalin të jenë shumë të frytshme për ta. (20.11.2020)

Qendra për karrierë dhe Alumni në bashkëpunim me organizatën Teach for Kosova me datë 24.11.2020, ora: 10.00, organizon info-sesion për Fellowship.

Fellowshipi i Teach For Kosova është një program dyvjeçar për zhvillim në mësimdhënie dhe udhëheqje për të rinjtë kosovarë të shquar dhe të aftë për të realizuar potencialin e tyre profesional dhe udhëheqës gjatë punës në klasë. Mësuesit e Teach For Kosova do të vendosen në shkolla publike të cilat kanë mungesë të mjeteve esenciale për zhvillim të mësimin, dhe do të mbështeten për dy vjet me trajnime intensive për zhvillim të lidërshiptit.

Teach For Kosova po kërkon individë të shquar kosovarë që të udhëheqin dhe të mësojnë nxënësit të sfidojnë sfondin socio-ekonomik për të arritur rritje të konsiderueshme akademike dhe personale. Nëse jeni një profesionist i punësuar ose një student universitar i diplomuar me aftësi të forta udhëheqëse, keni pasion për të bërë ndikim në jetën e fëmijëve dhe interesim për t'u bërë lider i përjetshëm në Kosovë, Aplikoni tani!

Për t'u kualifikuar, aplikantët duhet të plotësojnë kërkesat minimale të mëposhtme:

- Të jenë qytetarë kosovarë të moshës 35 ose më pak
- Të posedojnë diploma Bachelor në cilindo fakultet deri në korrik 2021

Derisa mësimdhënësit mund të aplikojnë, përvoja në mësimdhënie NUK është obligative për programin e Fellowshipit. Të gjitha drejtimet akademike dhe profesionale inkurajohen të aplikojnë.

Linkun per ndjekjen e Info-sesionit e gjeni këtu:

<https://us02web.zoom.us/j/8073979480> (23.11.2020)

Sot, më 25 nëntor 2020, u mbajt Panairi Nacional i Punës dhe Karrierës 2020, në të cilin morrën pjesë rreth 100 institucione dhe kompani pjesëmarrëse. Në mesin e tyre edhe Universiteti "Ukshin Hoti" nën përkujdesjen e Qendrës së Karrierës.

Këtë vit, Panairi Virtual i Karrierës u organizua në bashkëpunim edhe me Qendren për Zhvillim të Karrierës në Universitetin e Prishtinës, kurse Panairi i Punës i projektit DIMAK- GIZ edicionin e pestë dhe së bashku erdhën në një platformë të shkëlqyer virtuale në të cilën vizitorët kanë patur mundësi të vizitojnë standat e institucioneve e kompanive pjesëmarrëse të shpërndara në katër salla virtuale përmes ueb faqes: virtual.kosovafair.com

Gjatë panairit, vizitorët kanë patur mundësi të komunikojnë virtualisht me përfaqësuesit e kompanive pjesëmarrëse dhe të marrin pjesë në sesione informuese rreth përpilimit të CV-së dhe teknikave të intervistimit; Zhvillimit të shkathtësive të buta; përgatitjes adekuate për aplikime pune, etj.

Organizimin e kësaj ngjarje e kanë mbështetur partner tradicional te Universitetit të Prishtinës, si Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtare (GIZ), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës si dhe partner te tjerë. Platforma do të jetë e hapur për vizitorët edhe gjatë dy javëve të ardhshme. (25.11.2020)

<https://www.facebook.com/UniversityofPrizren/posts/pfbid0WufiV2Cn1xDTThkSTT2TE22saGH2VCqFcNvZ5iAciBdUfC61hFpsThdzoZhnM8L5l>

Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi në mes të Odës së Hotelarisë dhe Turizmit të Kosovës, dhe Qendrës për Karrierë&Alumn

Të premtën në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në mes të Odës së Hotelarisë dhe Turizmit të Kosovës, dhe Qendrës për Karrierë&Alumn, e cila funksionon në kuadër të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren. Prof. Hysen Sogojeva- Kryetar i Odës për Hoteleri dhe Turizëm e quajti të rëndësishëm nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, duke e ditur se nga kjo përfitojnë më së shumti studentët ku përmes praktikës së tyre profesionale marrin përvojën e tyre të nevojshme për profesionin e tyre të ardhshëm, për sa i përket lëmit të hotelarisë dhe gastronomisë.

Skender Thaçi- Nënkryetar i OHTK-së, theksoi se kjo marrëveshje është e një rëndësie të veçantë, duke e ditur se po bëhet për rininë tonë, studentët tanë, e të cilët e meritojnë përkrahjen më të madhe, duke e ditur se janë ardhmëria e vendit, dhe se praktika e tyre profesionale është ndihmesë e madhe për ta.

Burim Sallauka-Nënkryetar i OHTK-së, e faleminderoi Rektorin Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj, dhe Kryetarin e QKA-së z. Nehat Gashin për mundësinë dhe gadishmërinë për të bashkëpunuar, në të mirën e të dyja palëve, dhe u dakorduan për realizimin e Panairit të Punësimit Sezonal së bashku me QKA-në.

Rektori i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj i falenderoi për pjesëmarrjen e tyre përfaqësuesit e OHTK-së, kryetarin z. Hysen Sogojeva, nënkryetarët z. Skender Thaçin dhe z. Burim Sallauka, duke e cilësuar si tejet të nevojshme këtë marrëveshje bashkëpunimi. Rektori uroi që kjo marrëveshje të jetë sukseshme dhe jo të mbetet vetëm në letër, gjithashtu theksoi se na duhet vullneti për punë, kurse sukseset vijnë pas.

Ndërkaq z. Nehat Gashi- Koordinator i Qendrës për Karrierë dhe Alumn e cila funksionon në Universitetin e Prizrenit, theksoi se kjo marrëveshje në mes të OHTK-së dhe QKA-së është në të mirën e studentëve, dhe nga ky memorandum bashkëpunimi përfitues janë studentët, dhe se besojmë që praktikat e tyre t’i kryejnë në lëmitë përkatëse.

Në takim fjalën e mori edhe znj. Gentiana Gashi, ish-studente e Universitetit të Prizrenit, e diplomuar në nivelin master, në drejtimin e Trashëgimisë Kulturore, e cila u shpreh se ishte shumë e kënaqur me stafin administrativ dhe akademik të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

Në këtë takim mori pjesë edhe z. Përparim Abdullahu- Drejtor i Zyrës për Marrëdhënie me Jashtë, dhe Këshilltar i Rektorit. (18.12.2020)

<https://www.facebook.com/UniversityofPrizren/posts/pfbid02Crfp4pfGJfu7XmYhRQ5FYUm9H4u93TWzP5nfbzKJ2kU14tv7Bg7fdzuSyBiokK7Gl>

Qendra për karrierë dhe Alumni në kuadër të Universitetit Ukshin Hoti në Prizren, në bashkëpunim me GIZ-in, nesër (datë 06.05.2021, me fillim prej orës 13.00) do të zhvillojë trajnimin me temë: "Shkathtësitë e prezantimit".

Ky trajnim, kemi vlerësuar se do t’ju ndihmonte juve që të zhvilloni kualitetin profesional, meqë Shkathtësitë e Prezantimit përbëjnë një rëndësi të veçantë në jetën akademike dhe atë të punës. Për shkak të situatës pandemike, edhe këtë trajnim jemi të obliguar ta zhvillojmë online. (06.05.2021)

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0mdaidgUawXRonxeYCBofuU4wS3wM5s9MM9hiKKQJsyypDZEdbLQD33mdWrokkBLsl&id=101240494940518

Qendra për Karrierë dhe Alumni në bashkëpunim me American Advising Center, qendër e cila sponzorizohet nga Ambasada Amerikane në Kosovë, QKA ka organizuar sesion prezentues për mundësi studimi në nivelin Master në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (24.05.2021)

[https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02HeAymoSbJ4peBoixBBsyoLdm
bQSQkP8UpoF892uqYfsJDaaGUDjqvCZB8CYD1PK2l&id=101240494940518](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02HeAymoSbJ4peBoixBBsyoLdmbQSQkP8UpoF892uqYfsJDaaGUDjqvCZB8CYD1PK2l&id=101240494940518)

Prorektorja Plakiqi-Milaimi mbajti takim koordinues për aktivitetin Java e Mirëseardhjes 2021 për studentët e rinj

Prof. Ass. Dr. Albana Plakiqi-Milaimi Prorektor për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Kërkime Shkencore, dhe koordinatori i Qendrës së Karrierës&Alumni në Universitetit, z. Nehat Gashi, të enjten kanë mbajtur takim me dekanët e njësisë akademike, shefat e programeve studimore, kryetarin e Parlamentit Studentor dhe kryetarët e këshillave studentore në njësitë akademike, për të diskutuar për aktivitetin Java e Mirëseardhjes së studentëve të rinj në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren.

Prorektorja Plakiqi-Milaimi i njoftoi të pranishmit se Universiteti “Ukshin Hoti” sivjet do të organizojë aktivitetin Java e Mirëseardhjes për t’i ndihmuar studentët të përgatiten dhe të jen gati për të filluar studimet.

Është një kohë e dedikuar për studentët që të eksplorojnë Universitetin dhe kampusin, të takojnë studentët kolegë, mësimdhënësit, udhëheqësit e programeve dhe të mësojnë kuptimin e jetës studentore që i pret. Do tu ofrojmë informacion thelbësor për të filluar, mundësi për tu socializuar, eksploruar dhe kontribuar dhe t’ju sigurojnë përshtypjen e parë pozitive dhe lidhjen e qëndrueshme me Universitetin.

Për secilin program studimor në bazë të agjendës që do të publikohet, do të mbahet një takim mirëseardhës nga Dekani , shefi i programit, koordinatori i Qendrës së Karrierës dhe Kryetari i Këshillit studentor të njësisë akademike. Studentët do të njoftohen me programin studimor, mundësitë që ofron universiteti, do të njoftohen me strukturat e fakultetit dhe procesin mësimor. Këtë ditë studentët do të njoftohen me Doracakun e Studentit dhe me Doracakun e programit studimor.

Aktivitetet kryesore të mirëseardhjes do të organizohen më 18 dhe 19 tetor 2021, në bazë të agjendës që do të publikohet me kohë.

Sipas kërkesave shefat e programeve do të takojnë edhe personalisht studentët e interesuar, gjatë tërë javës në bazë të nevojave që kanë për sqarime shtesë. Kjo do të realizohet për 5 ditë prej 18 - 22 Tetor 2021., prej orës 9:00 deri 15:00.

Në ditët e Javës së Mirëseardhjes studentët do të mund të bëjnë vizitë nëpër kampus ku do të njohën me sallat mësimore, bibliotekën, laboratorët, bufenë, dhe hapësirat e tjera.

Ju rikujtojmë se për shkak të Pandemisë Covid-19, çdo student që hyn në Universitet duhet të posedoj njërën nga dëshmitë, bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 01/35 të datës 12.09.2021, për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19: Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plotë ose marrjen e një dozë të vaksinës kundër COVID-19; Testi RT-PCR negativ për COVID-19, jo më i vjetër se 72 orë; Dëshmi se personi ka kaluar COVID-19 (test RT-PCR pozitiv i lëshuar jo më pak se 21 ditë dhe jo më shumë se 180 ditë ose rezultat pozitiv i testit të antitropave setrologjik –IgG, i lëshuar më së shumti para 30 ditëve; Test i shpejtë antigjen negativ jo më i vjetër se 48 orë. (07.10.2021)

[\(Prorektorja Plakiqi-Milaimi mbajti takim koordinues për aktivitetin Java e Mirëseardhjes 2021 për studentët e rinj – UPZ \(uni-prizren.com\)\)](#)

Qendra e Karrierës dhe Alumnit në bashkëpunim me Caritasin Zviceran (CaCH) kanë arritur një bashkëpunim përmes të cilit mundësohen trajnimet lidhur me proceset e aplikimit për punë

(përpilim të CV dhe letrës motivuese), ndërmarrësi dhe aktivitete të ndryshme, nga ku, ju do të kenë mundësinë të mësoni se si të jeni më të suksesshëm në të ardhmen.

Projekti INTERK (Burimet ndërkulturore në Kosovë) ka të bëjë me të ardhurat e të rinjve të të gjitha grupeve etnike që jetojnë në Kosovë. Përmes kurseve të trajnimit në sipërmarrje, proceset e aplikimit për punë dhe shkrimin e propozimeve krijuese, nxiten kompetencat e krijimit të të ardhurave të 60 të rinjve. Kjo bëhet përmes punëtorive, kampeve rinore dhe 18 projekteve më të vogla. Të rinjtë (pjesëmarrës/kursantë) do të jenë individë të moshës midis 18-25 vjeç, të cilët nuk janë të punësuar ose punojnë me gjysëm orari, dhe flasin gjuhën angleze në një nivel bazë. Nën projektin INTERK, CaCH po zbaton aktivitetet e projektit në komunat vijuese: Fushë Kosovë, Graçanicë, Kamenicë, Obiliq, Obilić, Prizren dhe Shtërpce/Štrpce. Kështu, 60 të rinj pritet të jenë nga qytetet/fshatrat nga këto komuna.

Këta të rinj do të ndjekin një punëtori (tetor, 2021), një kamp dimëror (nëntor/dhjetor 2021) dhe një kamp veror (qershor/korrik 2022).

Një punëtori do të zgjasë një ditë, ndërsa të dy kampet do të organizohen gjatë fundjavave dhe do të zgjasin 3 ditë secila. (12.10.2021)

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0c855UD4ig16uD66zoFTKA6NC8rpJLlJqAos2SpvbenNqrQDw1S6Hwin2bXQIG72Jl&id=101240494940518

Në bashkëpunim me GIZ-in gjerman, QKA ka organizuar Panairin Virtual të Karrierës. Në këtë panair kanë qenë pjesëmarrëse kompani të ndryshme përmes të cilave studentët kanë pasur rastin të njihen me vende të reja pune. (26.10.2021)

[\(Panairi Virtual i Karrierës 2021 – UPZ \(uni-prizren.com\)\)](#)

Në amfiteatrin e Fakulteti Ekonomik, Qendra për Karrierë dhe Alumni në bashkëpunim me Teach for Kosova, do të mbajë sesion informues rreth mundësive të punësimit për studentët e vitit të fundit të studimeve dhe për studentët e nivelit master, nga të gjitha drejtimet. Sesioni informues do të jetë rreth hapjes për aplikimin Fellowship, mundësi që nuk duhet humbur! (10.10.2021)

[\(Teach of Kosova organizon infosesion – UPZ \(uni-prizren.com\)\)](#)

Qendra e Karrierës&Alumni e Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren pjesë e punëtorisë “Ngritja e kapaciteteve dhe rrjetëzimi ndërmjet zyrave të karrierës së universiteteve”

Më 18 nëntor 2021 u mbajt punëtorja “Ngritja e kapaciteteve dhe rrjetëzimi ndërmjet zyrave të karrierës së universiteteve”, e organizuar nga Qendra për Zhvillim të Karrierës në kuadër të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë.

Koordinatori i Qendrës së Karrierës&Alumni në kuadër të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren zt. Nehat Gashi si dhe Prof. Ass.Dr. Serdan Kervan morën pjesë në këtë punëtori dhe kontribuoi në mënyrë aktive, me qëllim të ndërlidhjes dhe vendosjes së bashkëpunimit të Qendrave të Karrierës së Universiteteve Publike të Kosovës. Ndërkaq, përveç vendosjes së bashkëpunimit u dakorduan që të kenë edhe një projekt të përbashkët për të zhvilluar këto qendra në mënyrën sa më të mirë.

Punëtorja u mbështet nga GIZ dhe DIMAK Kosova, të cilët janë bashkëpunues dhe motivues të vazhdueshëm për funksionalizimin e këtyre qendrave.

Pikat që u diskutuan në punëtori:

- Diskutim i raportit të konsulentës së angazhuar nga GIZ/DIMAK Kosova;
- Ofrimi i shërbimeve të karrierës për studentët dhe të diplomuarit;
- Resurset njerëzore dhe infrastrukurore;
- Ndërlidhjet institucionale;
- Ndërkombëtarizimi/regjionalizimi në praktikë;
- Rrjetëzimi me zyre simotra;

Buxheti për Zyrat e Karrierës/burimet tjera financiare që ndikojnë në rritjen e buxhetit dhe kualitetit të cilësisë së shërbimeve;

Zhvillimi i një strategjie/plani promovues;

Brendimi dhe digjitalizimi i shërbimeve të zyrave të karrierës për shtrirjen tek audienca e gjerë. (19.11.2021)

[\(Qendra e Karrierës&Alumni e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren pjesë e punëtorisë "Ngritja e kapaciteteve dhe rrjetëzimi ndërmjet zyrave të karrierës së universiteteve" – UPZ \(uni-prizren.com\)\)\]](#)

Sot më 25.11.2021, për nder të 28 Nëntorit Ditës së Flamurit, Parlamenti Studentor së bashku me Qendra për karrierë dhe alumni- Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren , zhvilluan Turnirin e Shahut, i cili tashmë do të organizohet tradicionalisht. Pjesëmarrës në këtë turnir përpos studentëve, ishin edhe profesorët dhe stafi nga Administrata e Universitetit. Fitues i turneut në fund u shpall student i Labeat Berisha i cili në finale mundi drejtorin e QKA z. Nehat Gashi.

Evenimente të tilla sportive dhe rekreative, Parlamenti Studentor do të organizojë edhe në të ardhmen për ta pasuruar sa më shumë jetën studentore me aktivitete jashtëkurrikulare.

Në fund, falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit për shpirtin sportiv për diciplinën e treguar! (25.11.2021)

<https://www.facebook.com/psupz/posts/pfbid02scS2x8ce1bQ782KR625joGZUiqi2DCvPGZMDYWaeF9bxRXPjCgUfVztxPK9nwtQI>

Sot më 26.11.2021, në vazhden e aktiviteteve për nder të 28 Nëntorit, QKA-ja së bashku me Parlamentin Studentor organizuan orën letrare me përmbajtje artistike.

Të ftuar pos studentëve ishin edhe menaxhmenti i UUHP - së, i ftuar ishte edhe ish rektori i Universitetit të Bujqësisë së Tiranës Prof. Dr. Bahri Musabelliu, dekanët, prodekanët, stafi akademik dhe ai administrativ.

Kjo ditë është një nga datat më të rëndësishme në mos më e rëndësishmja, e historisë kombëtare shqiptare.

28 Nëntori i parë shënon ngritjen e flamurit në tokat arbërore nga Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, Nëntori i dytë shënon ngritjen e flamurit në Vlorë nga Ismail Qemali dhe shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë së coptuar. Por 28 Nëntori për ne shqiptarët e Kosovës ka edhe vlera të tjera, sepse në këtë datë shënohet datëlindja e Komandantit Legjendar Adem Jasharit dhe më 1997 mu në këtë datë për herë të parë del në skenë Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Kremtimi i festave të Nëntorit nuk është vetëm një përvjetor i thjeshtë, është kremtimi i të qenit tonë shqiptar.

Në këtë datë të shënuar, përkulemi para veprës së të parëve tanë, për gjithë ata të cilët luftuan dhe flijuan vetën e tyre për lirinë dhe pavarësinë e atdheut tonë.

Falënderojmë të gjithë ata që kontribuan që ky program të ishte kaq madhështor! (26.11.2021)
<https://www.facebook.com/psupz/posts/pfbid023gpKooq6q9NxDtMLYrcjUkLr9trSbczBCKktU51DSRnazMJf64Xsn7bTjvXdVSv43l>

Sot në kampusin e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, studentët tanë së bashku me përfaqësuesit e Parlamentit Studentor zhvilluan aktivitetin e shitjes së kartolinave dhe qirinjve të punuar nga Qendra e Sindromës Down, të cilën e mundësoi për organizim Qendra e Karrierës dhe Alumni.

Bamirësia e vërtetë është dëshira për të qenë të dobishëm për të tjerët pa menduar për shpërblime. Aktivitetit tonë ju bashkangjit edhe Prorektorja për Mësim, Prof. ass. dr. Albana Plakiqi - Milaimi, e cila na përgëzoi për iniciativëm, dhe njëkohësisht shprehi gadishmëri të plotë që në të ardhmen të organizohen edhe shumë aktivitete të ngjashme humanitare.

Studentët e UUHP-së së bashku me stafin akademik dhe atë administrativ, kontribuan duke blerë punimet që janë punuar nga duart e arta të Qendrës Down Syndrome Prizren. Të hollat që u mblodhën në këtë aktivitet dedikohen për vetëfinancimin e Qendrës.

Me anë të këij postimi, ne ju falënderojmë të gjithëve që kontribuat me mundësitë tuaja që sot ta kalojmë një ditë me plot buzëqeshje të bukura.(28.12.2021)

(<https://www.facebook.com/psupz/posts/pfbid0wiwxTyrazxUE5ujhVFUfntpF8MM3A4m2k22oLdTpF3s2EFTKB77A82cc229AAAtGAI>)

U. “Ukshin Hoti” Prizren dhe ATRC lidhin memorandum bashkëpunimi

Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren dhe Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) të mërkurën kanë lidhur memorandum bashkëpunimi. Memorandumi është nënshkruar nga Prof. Asoc. Sc. Samedin Krrabaj u.d. Rektor dhe z. Kushtrim Kaloshi Drejtor Ekzekutiv i ATRC. Vlen të theksohet së për arritjen e kësaj marrëveshje është përkujdesur z. Nehat Gashi udhëheqës i Qendrës së Karrierës&Alumni. Bashkëpunimi do të fokusohet në bashkërendimin e aktiviteteve akademike dhe profesionale përmes: Realizimit të punës praktike për studentët e Fakultetit Juridik dhe fakulteteve të tjera relevante në kuadër të projekteve që zbatohen në Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim; Shkëmbimet e përvojave, praktikave të mira, ekspertëve dhe literaturës përkatëse për zhvillimin institucional, me qëllim të avancimit profesional dhe akademik të studentëve dhe stafit të Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim; Hartimin e programeve dhe projekteve të përbashkëta hulumtuese dhe kërkimore konform kërkesave dhe interesave të dy palëve; Organizimin e përbashkët të veprimtarive akademike, shkencore dhe profesionale si; simpoziume, seminare, konferenca, tryeza, shkolla verore, trajnime; ATRC, në kuadër të komponentës së monitorimit të gjykatave, monitorimit të institucioneve përgjatë implementimit të projekteve, përfshirë projektin e USAID për Drejtësi, do t’i angazhoj studentët nga Fakultetit Juridik dhe fakultetet e tjera relevante, me qëllim të monitorimit të rasteve gjyqësore. (26.01.2022)

([U. “Ukshin Hoti” Prizren dhe ATRC lidhin memorandum bashkëpunimi – UPZ \(uni-prizren.com\)](http://uni-prizren.com))

Udhëheqësi i QKA-së z. Gashi dhe Kryetari i Parlamentit Studentor z. Tredhaku vizituan

Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë

Udhëheqësi i Qendrës së Karrierës dhe Alumnit të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren z. Nehat Gashi, sot së bashku me Kryetarin e Parlamentit Studentor z. Fatlind Tredhaku dhe kryetaret e këshillave studentore znj. Erva Kuksi dhe Samire Karavidaj vizituan Universitetin “Haxhi Zeka” Pejë. Ata u pritën nga drejtori i kësaj qendre z. Abedin Selimaj, nga Nënkryetarja e Parlamentit Studentor znj. Albiona Kelmendi dhe Senatori i PS z. Vali Ahmetaj. Qëllimi i takimit ishte bashkëpunimi ndërmjet dy universiteteve dhe shkëmbimi i përvojave të qendrave të karrierës dhe alumnit dhe parlamenteve studentore dhe promovimi dhe avancimi i të drejtave të studentëve. Bashkërisht u dakorduar që takime të tilla të mbahen sa më shpesh.(02.02.2022)

([Udhëheqësi i QKA-së z. Gashi dhe Kryetari i Parlamentit Studentor z. Tredhaku vizituan Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë – UPZ \(uni-prizren.com\)](http://uni-prizren.com))

Në vazhden e aktiviteteve, për nder të përvjetorit së pavarësisë së Republikës së Kosovës , Qendra e Karrierës dhe Alumnit dhe Parlamenti Studentor së bashku me Këshillin Organizativ të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren organizuan një program me përmbajtje artistike dhe hapjen e ekspozitës "Kosova në arkivin e shtetit shqiptar".

Të ftuar pos studentëve ishin edhe menaxhmenti i universitetit, dekanët, prodekanët, stafi akademik dhe ai administrativ.

Kjo ditë është një nga datat më të rëndësishme në mos më e rëndësishmja, e historisë së Kosovës, pasi që mu në këtë datë të vitit 2008, Kosova shpallet shtet sovran dhe demokratik.

Kremtimi i festës së 17 Shkurtit nuk është vetëm një përvjetor i thjeshtë, është kremtimi i lirisë sonë që e pritëm me shekuj.

Në këtë datë të shënuar, përkulemi para veprës së të parëve tanë, për gjithë ata të cilët luftuan dhe flijuan vetën e tyre për lirinë dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës.

Falënderojmë të gjithë ata që kontribuan që ky program të ishte kaq madhështor! (15.02.2022) (<https://www.facebook.com/psupz/posts/pfbid02bh4VLALAEJHNghuWs12FBjeCeudauvG2ZfqVKzJdJrAtvAEguJThfYqYXcyKtV3VI>)

15.03.2022 Parlamenti Studentor së bashku me Koordinatorin e Qendrës së Karrierës dhe Alumnit z. Nehat Gashi të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren pritën në takim homologët nga Universitetit “Haxhi Zeka” Pejë dhe Universiteti “Fehmi Agani” Gjakovë.

Qëllimi i takimit ishte vazhdimi i bashkëpunimeve ndërmjet universiteteve dhe shkëmbimi i përvojave të QKA-ve dhe Parlamenteve Studentore.

Bashkërisht u dakorduam që takime të tilla të mbahën më shpesh duke zhvilluar edhe aktivitete të përbashkëta për avancimin e të drejtave të studentëve.(15.03.2022)

(<https://www.facebook.com/psupz/posts/pfbid02UADk7uPfAhYWK2xFbUWyncgxR9WrobAk2WeQqsMxLBFQhDPaSVW75wbBd3NTmtD1I>)

Ekipi i futsallit i Universitetit Ukshin Hoti fiton ndeshjen e parë të sezonit të ri në kuadër të Ligës Universitare të Kosovës. Në ndeshjen e parë ekipi i udhëhequr nga Udhëheqësi i Qendrës për karrierë dhe Alumni z. Nehat Gashi, mundën kampionët në fuqi, ekipin FEFS 2 me rezultat 2-1.

Universiteti Ukshin Hoti është i përkushtuar që të ofroj mbështetje edhe më të madhe për aktivitete jashtëkurrikulare në përgjithësi e për sportistët në veçanti. QKA-ja e universitetit Ukshin Hoti prej nga fillimi I themelimit vazhdimisht ka qenë e angazhuar për ti shtyer studentët në aktivitetet sportive. (07.04.2022)

(https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0Gz4QeHwQiu8NCzyg9HknJa3hBLrc84wjbrpVeqyUSdtvfXxJ51z2UNQPCaenWyqzl&id=101240494940518)

Qendra e Karrierës nisi projektin për orientim në karrierë të maturanëve

Qendra e Karrierës e Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, ka nisur realizimin e projektit nëpër shkollat e mesme të rajonit të Prizrenit për orientim në karrierë të maturanëve. Në këtë kuadër, të mërkurën është mbajtur takimi informues me maturanët e shkollave të mesme të komunës së Therandës. Koordinatorin e Qendrës së Karrierës z. Nehat Gashi, i shoqëruar nga Kryetari i Parlamentit Studentor z. Fatlind Tredhaku dhe asistenti i Fakultetit Juridik Ass. PhD cand. Milot Krasniqi i kanë njoftuar maturanët me ofertën akademike të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren për vitin akademik 2022/2023. Maturanët u njoftuan për programet studimore, mënyren e aplikimit, kushtet infrastrukturore dhe mbështetjen që ofron për studentët e rinj ky Universitet. Ditëve në vijim do të vazhdojë fushata nëpër komunat tjera të rajonit të Prizrenit. (20.04.2022)

([Qendra e Karrierës nisi projektin për orientim në karrierë të maturanëve – UPZ \(uni-prizren.com\)](https://www.uniprizren.com))

Universiteti Ukshin Hoti në Prizren mori pjesë në garën tradicionale të futsallit në Antwerpen të Belgjikës. Djemtë e Universitetit arritën deri në çerekfinale të turnamentit duke shënuar rezultate shumë të mira, madje duke e mundur edhe ekipin e Universitetit Bon Rhein nga Gjermania me rezultat të thellë prej 7-2.

Organizimi i kësaj ngjarjeje sportive u mundësua përmes Qendrës së Karrierës dhe Zyrës për marrdhëje me jashtë.

Universiteti Ukshin Hoti mbetet i përkushtuar që t'i mbështes me të gjitha kapacitetet e saja të gjitha aktivitetet studentore e sidomos ato sportive. (29.04.2022)
(<https://www.facebook.com/UniversityofPrizren/posts/pfbid02RoVLrATpr53GvSN3j9gfKPJoiGhvXpCQuWx8N8kwcFqUeg7DccMxRKDdGU6W4aAql>)

Aktiviteti informues Boost Employment

Sot më 24.11.2022 në amfiteatrin e Fakultetit Ekonomik, Koordinatorin e QKA-së z. Nehat Gashi së bashku me përfaqësues të projektit Swisscontact.

Aktiviteti ishte i mirëseardhur nga studentët e universitetit me ç'rast pati interesim të madh nga ana studentëve pasi që i tërë projekti ka të bëjë rreth mundësive të punësimit, sipërmarrjeve, praktikave, këshillimeve dhe promovimeve.

Të gjitha këto mund të kryhen nga platforma [Mundesi.com](https://www.mundesi.com) e cila edhe ju prezantua studentëve tanë.

Aktivitete të tjera që janë kësisoj në dobi të studentëve do të vazhdoj të ketë edhe në të ardhmen e afërt!(24.11.2022)

(<https://www.facebook.com/psupz/posts/pfbid02AtevREiZ6CvFCyhYm8e6oHp7Pi3ou659xrq6Yp1Nbx3i2wxGf8m9kaTJ4A9Pzqxel>)

Panairi Kombëtar i Punës, Karrierës dhe Ndërmarrësisë 2022

Sot më 30.11.2022 në sallën 1 Tetori në Prishtinë u organizua Panairi Kombëtar i Punës, Karrierës dhe Ndërmarrësisë.

Panairi ishte i ndarë në tri Pavijone(Punësimit, Karrierës dhe Ndërmarrësisë), Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren e kishte pikën e tij në Pavijonin e Karrierës në krye me Koordinatorin e Qendrës së Karrierës dhe Alumnit z. Nehat Gashi.

Nga universiteti ynë u organizuan studentë që të marrin pjesë në këtë panair që tani është kthyer traditë vjetore dhe se është mundësi shumë e mirë e studentëve tanë për punësim.

Në sallën 1 Tetori, Koordinatorin Gashi i priti studentët, me ç'rast edhe ju foli më hollësisht rreth Panairit dhe i shoqëroi ata sa qëndruan aty.

Organizimet e tilla janë vazhdimisht në dobi të studentëve dhe ashtu do të vazhdojnë gjithmonë të kenë përkrahjen e universitetit. (30.11.2022)

(<https://www.facebook.com/psupz/posts/pfbid0zYsa4BiJUuJkvhLgrzYjUc28NMfLh4EaKWIEDsc2WZTqxf7VS19xV7BTVMoUMmewl>)

